

Duke pasur parasysh se sektori i energjisë është vlerësuar si një mundësi e madhe për zhvillimin e Ballkanit Perëndimor, dhe në këtë mënyrë edhe i Serbisë, Malit të Zi dhe Bosnjes dhe Hercegovinës, gjegjësisht Republikës Srpska, dhe se vendimet për vlerësimin e burimeve të energjisë që do të zhvillohen në periudhën e ardhshme do të jenë të rëndësishme avacmin e zhvillimit të përgjithshëm ekonomik të vendit tonë, deputetë e Kuvendit të Republikës së Serbisë, Malit të Zi dhe Republikës Serpska, në një takim të përbashkët në kuadër të Komitetit të rjetit për ekonomi , financa dhe integrim evropian të Ballkanit Perëndimor të mbajtur në Trebinjë, më 31 mars u miratuan këto rekomandime dhe qëndrime:

1. Duhet të përforcohet mbikëqyrja parlamentare në fushën e energjisë, si dhe të rritet transparenca në vendimet kyçe në këtë fushë, me përfshirjen e plotë të Parlamentit në dhe përputhje me përgjegjësitë e autoritetit legjislativ;
2. Duhet të inicohet përpilimi i një dokumenti të përbashkët të Republikës së Serbisë, Malit të Zi dhe Republikës Srpska për bashkëpunim në fushën e energjisë, dhe të ndërmerret iniciativë për harmonizimin e rregullave legjislative në fushën e energjisë, si dhe në përcaktimin e prioritetëve të përbashkëta për investime në këtë fushë;
3. Rëndësi të veçantë ka intensifikimi i bashkëpunimit në mes të Republikës së Serbisë, Malit të Zi dhe Republikës Srpska në fushën e energjisë në drejtim të arritjes së një marrëveshje, me qëllim të rritjes së efikasitetit të energjisë, efikasitetit në mbrojtjen e mjedisit dhe racionalizimin e biznesit të kompanive publike të energjisë elektrike;
4. Ekziston nevoja për ripërcaktimin e marrëdhënieve financiare midis komuniteteve lokale dhe ndërmarrjeve në fushën e energjisë të cilat janë në domen publik, në drejtim të arritjes së përfitimeve adekuate për komunitetet lokale të arritura nëpërmjet vlerësimit të burimeve të energjisë në zonën e tyre, duke respektuar rekomandimet e Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale;
5. Duke pasur parasysh interesat ekonomike dhe të energjisë, Serbia , Mali i Zi dhe Republika Srpska, si dhe nevoja për bashkëpunim në zbatimin e projekteve të përbashkëta, dhe faktin se zbatimi i projekteve të caktuara në fushën e energjisë termike, në këtë kuptim, është i domosdoshëm për të përcaktuar interesat e përbashkëta dhe vlerësimin e potencialeve ekzistuese hidroenergjetike, sikur të tilla si projektet e HC "Boka" dhe HC "Buk Bjela";
6. Është akorduar se do të mbahet konferenca rajonale e parlamentarëve, me parlamentet e vendeve të Ballkanit Perëndimor, me temën e energjisë, në fund të shtatorit në Mal të Zi, me pjesëmarrjen e delegatëve të pushtetit ekzekutiv, si dhe të komunitetit akademik dhe afarist në këtë fushë me qëllim të konkretizimit të aktiviteteve që kanë për qëllim fuqizimin e bashkëpunimit rajonal në fushën e energjisë.